

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me sekretaren juridike Shemsije Shehu, në lëndën penale kundër të akuzuarit D. Xh. nga fshati P., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag. 6 lidhur me parag.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.606/2016 të datës 11.06.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me datë 21.06.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.606/2016 të datës 11.06.2018, andaj gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari,

D. XH., nga i ati G., e ëma Gj., mbiemri i vajzërisë O., i lindur me datë ..., në fshatin P., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani banon, i martuar, baba i një fëmije, i pa punë, me gjendje së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal ..., të lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me datë 24.05.2016, rreth orës 20:00/h, në aksin rrugor Xërxë-Kramovik, pikërisht në fshatin G., Komuna e Rahovecit, derisa po e drejtonte automjetin e tij të udhëtarëve të markës “EV-Cady”, me ngjyrë të bardhë me targa të regjistrimit ...-...-... në kundërshtim me nenin 42 lidhur me nenin 54 të Ligjit mbi Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit apo mosveprimit të tij, por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet ose do të parandalojë shkaktimin e saj dhe pasoja është shkakuar në atë mënyrë që i akuzuari D. me automjetin e tij duke mos iu përshtatur shpejtësisë së lëvizjes, kushteve dhe rrethanave të rrugës, kyçet në mënyrë të pasigurtë duke ia pamundësuar lëvizjen e lirë të dëmtuarit A. A. Rr. , i cili ishte duke lëvizur drejt në shiritin e tij me

veturën Opel Kadet me targa ...-...-..., (pa patent shofer), ku i njëjti duke mos mundur ti shmangët rrezikut, me pjesën e parë ballore e godet në mes të anës së majtë automjetin VW-Cady, me ç'rast përpos dëmeve materiale, lëndime trupore marrin të dëmtuarit: S. E., M. E., E. E., L. E., K. E., N. E., A. E., dhe i pandehuri A. Rr. të konstatuara si në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. F. B. të dt. 10.08.2016.

Këso dore ka kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag. 6 lidhur me parag.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41, 46, 73, 378 parag. 6 lidhur me parag. 1 të KPRK-së, nenit 365 dhe 493 të KPPK-së, të akuzuarit ia shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Në shumën prej dyqind (200) euro, të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta paguajë në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën sipas nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet në dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditëve, duke llogaritur çdo ditë të burgimit me nga njëzetë (20) euro.

Të dëmtuarit: S., M., E., L., K., N., A. të gjithë E., nga fshati P., Komuna e Prizrenit dhe A. Rr. nga fshati R., Komuna e Rahovecit, udhëzohen që kërkesën pasurore – juridike ta realizojnë në procedurën e rregullt civile.

Obligohet i akuzuari të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 50.00 euro, ekspertizës së komunikacionit shumën prej 40.88 euro dhe në emër të shpenzimeve paushalle të paguajë shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.606/2016 të datës 11.06.2018, kundër të akuzuarit D. Xh. nga fshati P., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 parag.6 lidhur me parag.1 të KPRK-së, si dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga ana e të akuzuarit.

Gjykata pas shqyrtimit të kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor në kuptim të nenit 493 paragrafi 1 të KPPK-së.

Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: Raporti i hetuesit mbi vend-shikimin e aksidentit, i parashtruar nga Njësiti Regjional i Trafikut – Gjakovë, i datës 24.04.2016DR, me numër të rastit ER-3004-01232-2016, skica nga vendi i ngjarjes, e aksidentit (e punuar nga Zyrtari Policor D. B.-0858); raportet mjekësore të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë - Reparti i Emergjencës: i të pandehurit A. Rr., i datës 24.04.2016, për të dëmtuarit: S. E., M. E., E. E., L. E., K. E., A. E., N. E., A. E., i Dr. F. B. i datës 10.08.2016, për të dëmtuarit e lartcekur; ekspertiza e ekspertit të komunikacionit K. A. R., me numër PP/II.nr.606/2016, e datës 18.05.2016; foto-dokumentacioni si dhe shkresat tjera në lëndë, gjykata konstaton se këto prova janë bindëse, të besuara dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, prandaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarëve që kërkesën pasurore-juridike ta realizojnë në procedurën civile bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor bazohet në nenin 450 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 452 paragrafi 1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr. 407/17me datën 21.06.2018

Sekr. Juridike

Gjyqtari i vetëm gjykues

Shemsije Shehu

Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimit mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimin, për Gjykatën Themelore Gjakovë – Dega Rahovec.